



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-4824/21 datë: 23.02.2021



Npi – 01/58 datë: 01.03.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 01.03.2021 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 01.03.2021 (e hënë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtoresha e DPUKGJ-së znj.Shqipe Rexhaj, z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; z.Benik Shala, zyrtar i personelit. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më 20.11.2020 dhe 25.01.2021,
2. Raport i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të komunës së Shtimes për vitin 2020,
3. Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020,
4. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit,
5. Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
6. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Raçak,
7. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petrovë,
8. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Shtime,
9. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petroviç (Lagja e Pajtimit),
10. Propozim –Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm N.K-1397/16, ZK-Shtime,
11. Shqyrtimi i Kërkesave.

Procesverbali Npi-01/58 i datës 01.03.2021

Me kërkesën e Kryesueses së Kuvendit znj.Medina Brahaj, diskutimi për mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa më datën 26.03.2021, anëtarëve të KPF-së u është dërguar në formë elektronike në CD-Disc, dhe në formë të tillë e kanë miratuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 01.03.2021, me shumicën e votave miratoi procesverbalet në formë elektronike (CD-Disc) të datave: 01.03.2021, 26.03.2021, 01.06.2021, 22.06.2021, 09.07.2021 dhe 24.08.2021.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

